1791

32/2

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

MINISTRIA E INFRASTRUKTURËS DHE ENERGJISË
INSTITUTI I NDËRTIMIT

Nr 343/1 prot Datë 03/03 2021

Lënda: Jepet informacioni/dokumentacioni i kërkuar.

Kërkuesit: **Av. Dorian Matlija**
Drejtor Ekzekutiv
Qëndra Res Publica
Adresa: Blv Gjergj Fishta Nd.24 H.3 Ap.7 Tiranë

Në cilësinë e kërkuesit keni depozituar pranë Institutit të Ndërtimit, në përputhje me nenin 11 të Ligjit nr.119/2014, "Për të drejtën e Informimit", kërkesën për dhënie informacioni, rregjistruar me numër 343 prot, datë 22.02.2021 ku ju kërkoni informacion në lidhje me kopje të akt ekspertizave dhe oponencave teknike të Pallatit 145 dhe pallatit 146 rruga "Sokrat Moska" Njësia Administrative nr. 6. Po ju dërgojmë bashkëngjitur kësaj shkrese përcjellëse kopje të oponëncave teknike të akt ekspertizave të thelluara për objektet Pallati 145, 146 me adresë Rruga Sokrat Moska. Gjithashtu këtë informacion (kopje të akt ekspertizave dhe oponencave teknike të pallatit 145,146 po ju a dërgojmë dhe në adresën tuaj të emailit: qendra.respublica@gmail.com)

Duke Ju falenderuar.

Artan SHKRELI
DREJTOR I PËRGJITHSHËM

REPUBLIKA E SHQIPËRISË - MINISTRIA E INFRASTRUKTURËS DHE ENERGJISË - INSTITUTI I NDËRTIMIT TIRANË

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E INFRASTRUKTURËS DHE ENERGJISË
INSTITUTI I NDËRTIMIT

Nr. ... prot. Datë ... /2020

Lënda: **Dërgim përgjigje për Oponencën Teknike të akt ekspertizës së thelluar**

BASHKISË TIRANË

Sheshi "Skënderbej" nr.2, Tiranë

Në bazë të kërkesës suaj me Nr.23583 Prot. datë.15.07.2020, protokolluar me tonën me Nr.1686 Prot. datë.15.07.2020, **"Kërkesë për kryerjen e Oponencës Teknike të akt ekspertizës së thelluar"**. Bazuar në **Nenin 34**, të Aktit Normativ Nr.9, datë.16.12.2019, të Këshillit të Ministrave. "Për përballimin e pasojave të fatkeqësisë natyrore", të objektit: **"PALLATI 145", RRUGA "SOKRAT MOSKO", TIRANË**, **konkludojmë se:**

Akt ekspertiza e hartuar, nga shoqëria **"DEA-N CONSULTING STUDIO"** me **Ing. Konst. Dhimitër PAPA**, jep analizë të gjendjes ekzistuese, të dhëna mbi materialet e ndërtimit, të dhënat nga projekti i zbatimit, dëmtimet, etj.

Sipas Akt ekspertizës objekti është një godinë 5 kate mbi tokë ndërtuar rreth viteve 1970 me një sipërfaqe rreth 650 m^2/kat. Sipërfaqja totale llogaritet rreth 2615.78 m^2 në total. Sistemi strukturor i godinës është me muraturë mbajtëse tulle silikate. Materialet e ndërtimit nga provat rezultojnë me beton C16/20, çelik me fyk=25000N/mm^2, muratura me fm=1.22N/mm^2. Koeficienti i sigurisë për këtë objekt është marrë 1.35 (Limited Knowledge).

Nga inspektimet dhe analizat e kryera vihet re që tërmeti i datës 26.11.2019 ka lënë pasoja dhe dëme të konsiderueshme në strukturë.

Struktura është projektuar në bazë të kushteve shqiptare KTP dhe nuk i përgjigjet kërkesave të Eurokodeve, prandaj ka nevojë për tu përshtatur sipas tyre. Në akt ekspertizë jepen dhe tipet e ndërhyrjes në strukturë të cilat konsistojnë në riaftësim përshtatje/përmirësim i plotë strukturor i godinës sipas kërkesave sizmike dhe strukturale referuar Eurokodeve.

Pra Akt Ekspertiza ka dalë me konkluzionin që godina duhet të Riaftësohet/Përshtatet dhe përmirësohet sipas kushteve të reja sizmike dhe strukturale konform Eurokodeve.

Në dokumetet e paraqitura për oponencë teknike është dhënë dhe projekti i përforcimeve i hartuar nga shoqëria "DEA-N CONSULTING STUDIO", shoqëruar me raportin teknik përkatës.

Në raportin e vlerësimit strukturor autorët shprehen:

Perfundimisht mund te konkludojme, qe kjo ndertese ne gjendjen egzistuese i ploteson kushtet e sigurise dhe qendrueshmerise per ngarkesa statike por nuk i ploteson ato per ngarkesa dinamike sizmike, referuar gjendjes se pare kufitare si dhe kriteret e sherbimit ne nje dhe determine nje tjeter gjendje se dyte kufitare (gjendjes kufitare te shfrytezimit) duke u bazuar ne Eurocode per aktivitet sizmik me PGA = 0.260 g.

Struktura e objektit ne gjendjen egzistuese nuk i ploteson kushtet e sigurise dhe qendrueshmerise per nje vend sizmik sic eshte Tirana dhe duhet ti nenshtrohet restaurimit dhe perforcimit, mbi bazen e specifikave teknike te projektit perkates bashkengjitur.

Rekomandojme qe struktura e mesiperme te perforcohet dhe te restaurohet konform projektit perkates.

Rekomandime për ndërhyrjet strukturale të nevojshme për kthim të strukturës konform kushteve teknike dhe përshtatjen sipas standardeve shqiptare ose specifikimeve teknike dhe ose standardeve të tjera të barasvlefshme

Në bazë të analizave të kryera autorët kanë dal në përfundimin që struktura të kthehet në standartet e sigurisë të kërkuara nga kodet e sotme Europiane të projektimit duhet ti nënshtrohet ndërhyrjeve përforcuese.

Projekti i përforcimit konsiston në përforcimin e elementëve strukturore.

Struktura do te perforcohet duke nderhyre ne muret mbajtese me veshje me beton torkrete (me resistence jo me pak se 40 MPa) dhe zgara celiku T 131 me diameter 5 mm 150 mm. Zgarat do te lidhen me shufra terthore me diameter 8 mm dhe do te vendosen ne te dyja faqet e murere. Te dyja zgarat do te lidhen me shufra-fitila terthore te vendosura konform projektit konstruktiv.

Soletat, te realizuara me panele te parapregatitura do te perforcohen duke perdorur zgara te tipeve T 188 siper dhe T 92 poshte. Nga siper soletat do te vishen me beton C20/25 dhe nga poshte do te vishen me beton torkrete. Lidhja e te dyja shtresave do te behet me shufra terthore te cilat do te futen ne zonat e bashkimit te paneleve. Soletat gjithashtu do te lidhen me muraturen nepermjet shufrave te cilat do te inkastrohen ne faqen e jashtme te murit me ane te pllakave metalike.

Projekti i përforcimit është i detajuar dhe me shënimet e nevojshme teknike. Materialet që do të përdoren janë konform kushteve teknike. Mbi bazën e këtij projekti është hartuar dhe një preventiv me një vlere të punimeve të përforcimit *60 778.728 lekë me tvsh* e cila duke e krahasuar me vlerën totale të ndërtimit të objektit nga e para **2615.78 m² * 32113 lekë/m² = 84.000.543.14** duke iu referuar kostove ndërtimore në treg për një sipërfaqe të njëjtë është më e madhe se 70% (72.3% > 70%).

Pra si përfundim mund të themi se Akt eksertiza e thelluar për objektin "PALLATI 145", Rruga "Sokrat Mosko", është e detajuar dhe e bazuar në studime, prova laboratorike dhe analiza strukturore të plota.

Nga analiza e kësaj ekspertizë dhe vlerës së punimeve të rikonstruksionit dalim si përfundim që "PALLATI 145", RRUGA "SOKRAT MOSKO", TIRANË duhet të Prishet dhe të Ndërtohet e Re.

Projekti i ndërtimit pallatit të ri të hartohet konform Eurokodeve 8 për nivelin e performancës për rastin e efekteve sizmike.

Projekti të zbatohet konform Eurokodit 8-3. Projekti si dhe Punimet e zbatimit të kryhen nga shoqëri të licensuera, për këto lloj punimesh. Përgjegjësia për projektin është autorit të projektit të projektit

DREJTOR I PËRGJITHSHËM
Ing. Agron Hyseallliu

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E INFRASTRUKTURËS DHE ENERGJISË
INSTITUTI I NDËRTIMIT

Nr.1049 prot   Date 21.07.../2020

Lënda: **Dërgim përgjigje për Oponencën Teknike të akt ekspertizës së thelluar**

BASHKISË TIRANË

Sheshi "Skënderbej" nr.2, Tiranë

Në bazë të kërkesës suaj me Nr.24966 Prot. datë.24.07.2020, protokolluar me tonën me Nr.1850 Prot. datë.24.07.2020, **"Kërkesë për kryerjen e Oponencës Teknike të akt ekspertizës së thelluar"**. Bazuar në **Nenin 34**, të Aktit Normativ Nr.9, datë.16.12.2019, të Këshillit të Ministrave. "Për përballimin e pasojave të fatkeqësisë natyrore", të objektit: **"PALLATI 146", RRUGA "SOKRAT MOSKO", TIRANË, konkludojme se:**
Akt ekspertiza e hartuar, nga shoqëria INSTITUTI **"DEKLIADA-ALB"**, jep analizë të gjendjes ekzistuese, të dhëna mbi materialet e ndërtimit, të dhenat nga projekti i zbatimit, dëmtimet, etj.

Sipas Akt ekspertizës objekti është një godinë pjesërisht me 4 kate mbi tokë dhe është i rregullt si në plan ashtu edhe në lartësi. Sipërfaqja për kat është rreth 650 m² për kat. Sipërfaqja totale llogaritet rreth 1230 m² në total. Sistemi strukturor i godinës është me muraturë mbajtëse me tulla silikate si dhe me strukturë horizontale me soleta të parapërgatitura beton arme si dhe breza në zonat e mbështetjes së soletave. Themelet janë realizuar me rripa të kryqëzuar prej murature guri dhe butobetoni, me thellësi të tabanit rreth 130 cm referuar kuotës së tokës natyrale dhe rreth 190 cm referuaru kuotës +0.00. Objekti është ndërtuar rreth viteve 1970.
Materialet e ndërtimit nga provat rezultojnë me beton C16/20, çelik me fyk=25000N/mm², muratura me markë të tullës 75 dhe llac me markë 12. Niveli i njohjes është KL2. Koeficienti i sigurisë për këtë objekt është marrë 1.35 (Limited Knowledge).
Nga inspektimet dhe analizat e kryera vihet re që tërmeti i datës 26.11.2019 ka lënë pasoja dhe dëme të konsiderueshme në strukturë.
Struktura është projektuar në bazë të kushteve shqiptare KTP dhe nuk i përgjigjet kërkesave te Eurokodeve, prandaj ka nevojë për tu përshtatur sipas tyre. Në akt ekspertizë jepen dhe tipet e ndërhyrjes në strukturë të cilat konsistojnë në riaftësim përshtatje/përmirësim i plotë strukturor i godinës sipas kërkesave sizmike dhe strukturale referuar Eurokodeve.

Në dokumetet e paraqitura për oponencë teknike është dhënë dhe projekti i perforcimeve i hartuar nga shoqëria INSTITUTI "DEKLIADA-ALB", shoqëruar me raportin teknik përkatës.

Në raportin e vlerësimit strukturor autorët shprehen:

Perfundimisht, mund te konkludojme, qe kjo ndertese ne gjendjen egzistuese i ploteson kushtet e sigurise dhe qendrueshmerise per ngarkesa statike por nuk i ploteson ato per ngarkesa dinamike sizmike, referuar gjendjes se pare kufitare si dhe kriteret e sherbimit ne ulje dhe deformime referuar gjendje se dyte kufitare (gjendjes kufitare te shfrytezimit) duke u bazuar ne Eurocode per aktivitet sizmik me PGA = 0.260 g.

Struktura e objektit ne gjendjen egzistuese nuk i ploteson kushtet e sigurise dhe qendrueshmerise per nje vend sizmik sic eshte Tirana dhe duhet ti nenshtrohet restaurimit dhe perfocimit, mbi bazen e specifikave teknike te projektit perkates bashkengjitur.

Rekomandojme qe struktura e mesiperme te perforcohet dhe te restaurohet konform projektit perkates.

Rekomandime për ndërhyrjet strukturale të nevojshme për kthim të strukturës konform kushteve teknike dhe përshtatjen sipas standardeve shqiptare ose specifikimeve teknike dhe/ose standardeve të tjera të barasvlefshme.

Pra Akt Ekspertiza ka dalë me konkluzionin që godina duhet të Riaftësohet/Përshtatet dhe përmirësohet sipas kushteve të reja sizmike dhe strukturale konform Eurokodeve.

Në bazë të analizave të kryera autorët kanë dal në përfundimin që struktura të kthehet në standartet e sigurisë të kërkuara nga kodet e sotme Europiane të projektimit duhet ti nënshtrohet ndërhyrjeve përforcuese.

Projekti i përforcimit konsiston në përforcimin e elementëve strukturore.

Struktura do te perforcohet duke nderhyre ne muret mbajtese me veshje me beton torcrete (me resistence jo me pak se 40 MPa) dhe zgara celiku T 131 me diameter 5 mm/150 mm. Zgarat do te lidhen me shufra terthore me diameter 8 mm dhe do te vendosen ne te dyja faqet e mureve. Te dyja zgarat do te lidhen me shufra-fitila terthore te vendosura konform projektit konstruktiv.

Soletat, te realizuara me panele te parapregatitura do te perforcohen duke perdorur zgara te tipeve T 188 siper dhe T 92 poshte. Nga siper soletat do te vishen me beton C20/25 dhe nga poshte do te vishen me beton torcrete. Lidhja e te dyja shtresave do te behet me shufra terthore te cilat do te futen ne zonat e bashkimit te paneleve. Soletat gjithashtu do te lidhen me muraturen nepermjet shufrave te cilat do te inkastrohen ne faqen e jashtme te murit me ane te pllakave metalike.

Projekti i përforcimit është i detajuar dhe me shënimet e nevojshme teknike. Materialet që do të përdoren janë konform kushteve teknike. Mbi bazën e këtij projekti është hartuar dhe një preventiv me një vlerë të punimeve të përforcimit *34.596.519 lekë me tvsh* e cila duke e krahasuar me vlerën totale të ndërtimit të objektit nga e para **1230 m² * 32113 lekë/m² = 39,498,990** duke iu referuar kostove ndërtimore në treg për një sipërfaqe të njëjtë është më e madhe se 70 %. (87.59% > 70%).

Pra si përfundim mund të themi se Akt eksertiza e thelluar për objektin "PALLATI 146", Rruga "Sokrat Mosko", është e detajuar dhe e bazuar në studime, prova laboratorike dhe analiza strukturore të plota.

Nga analiza e kësaj ekspertizë dhe vlerës së punimeve të rikonstruksionit dalim si përfundim që "PALLATI 146", RRUGA "SOKRAT MOSKO", TIRANË duhet të Prishet dhe të Ndërtohet e Re.

Projekti i ndërtimit pallatit të ri të hartohet konform Eurokodeve 8 për nivelin e performancës për rastin e efekteve sizmike.

Projekti të zbatohet konform Eurokodit 8-3. Projekti si dhe Punimet e zbatimit të kryhen nga shoqëri të licensuara, për këto lloj punimesh. Përgjegjësia për projektin është autorit të projektit të projektit

DREJTOR I PËRGJITHSHËM
Ing.Agron Hysenlliu